REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 35/17
Datë/Datum. 02.02.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: Ministria e Administrates Publike

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **202 16 115 121**

Sa i përket tenderit për: **Furnizim me inventar per nevojat e MAP-it**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Graniti Shpk
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rruga "Xhavit Sylaj Nr 37
(Adresa)

Suhareke — ***23000***
(Vendi) — *(Kodi postar)*

044 111 572 — _____
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Bajram Lumi
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

granitiholding@gmail.com
(Adresa elektronike)

02.02.2017
(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar GRANITI SH.P.K.

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar GRANITI SH.P.K.

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi eshte publikuar ne KRPP: - ***Njoftim per kontrate 05.12.2016*** - ***Dorzimi i dosjes se tenderit 20.12.2017, ora 14:00*** - ***Njoftim per anulim 17.01.2017***

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [w] **Jo** [ ]

Po kemi marre pjese ne procesin e hapjes, ne kemi dorzuar oferten ne forme fizike dhe kemi qen i vetmi OE dhe nuk ka pasur ofertues tjeter ne forme fizike dhe elektronike, per kete deshmon edhe raporti i hapjes se ofertave.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [w] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar GRANITI SHP.K

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [w] Jo [ ]

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se. ***Kemi bërë kërkesë për rishqyrtim me dt: 20.01.2017*** ***E kemi marr vendimin për refuzim me dt: 24.01.2017***

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ne supozojna se jane shkelur keto dispozita te LPP: ***Neni 62 i LPP*** ***Neni 7 i LPP*** ***Neni 6 i LPP*** ***Neni 1 i LPP*** ***Neni 44.7 i rregullave dhe udhëzuesit për prokurim publik***

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Ne kemi dorëzuar ofertën tonë kopje fizike dhe kemi marr pjesë në hapje të ofertave, e ku si dëshmi e kemi procesverbalin e hapjes së ofertave. ***Ligji i prokurimit publik lejon që të vazhdohet edhe me një ofertë të përgjegjshme dhe se ne këtë rast ska asnjë bazë ligjore që të mos vazhdohet me vlerësim të ofertave.*** ***Anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit është bërë pa asnjë bazë ligjore në mënyrë arbitrare dhe në kundërshtim me nenin 62 të ligjit për prokurim publik.*** ***Në arsyen e anulimit tek njoftimi për anulim të këtij aktiviteti autoriteti kontraktues thotë se një shkelje e LPP-se ka ndodhur apo do të ndodh në***

Shtypëri me përgjegjësi të kufizuarë GRANITI SH.P.K.

procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit.
Ky arsyetim është shabllon dhe nuk ka ndonjë bazë për anulim dhe asnjë mbështetje ligjore.

Arsyeja e eliminimit nga autoriteti kontraktues nuk ekziston në asnjë pikë edhe në nenin 44.7 të rregullave dhe udhëzuesit operativ për prokurim publik ku tregohen arsyet kur mund të anulohet një aktivitet i prokurimit pas marrjes së ofertave. Njashtu ne nuk e dijme se ku janë bazuar autoriteti kontraktues në cilin ligj a dispozite kur e kanë anuluar këtë procedurë prokurimi.
Ne dëmtohemi në këtë proces pa asnjë arsye, duke qen se ne i plotësojmë të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe jemi kandidat potencial për të fituar këtë kontratë.

Ne jemi diskriminuar në këtë rast në kundërshtim me nenin 7 të ligjit për prokurim publik, pasi në atë nen shkruan qartë se operatorët ekonomik duhet të trajtohen në mënyre te barabarte dhe jodiskriminuese duke pas parasysh qëllimin dhe lenden e prokurimit. Por ne jemi diskriminuar nga autoriteti kontraktues duke mos vazhduar me vlerësim te ofertave edhe pse janë plotësuar te gjitha kushtet ligjore.

Njashtu është shkelur edhe neni 6 i LPP ku shkruan se Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit. Kurse autoriteti kontraktues si ka pasur parasysh në këtë rast ruajtjen e fondeve publik por ne mënyrë tendencioze e ka anuluar këtë aktivitet te prokurimit.
Autoriteti kontraktues njashtu në këtë aktivitet nuk e ka respektu edhe nenin 1 të ligjit për prokurim publik pasi dihet se qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike etj, mirëpo autoriteti në këtë rast ska të bëjë fare me transparencën dhe shfrytëzimin efikas të fondeve por përkundrazi me shkelje të këtyre parimeve në mënyre shumë tendencioze dhe pa ndonjë arsye.

Kërkojmë nga organi shqyrtues i prokurimit publik që të detyrojë autoritetin kontraktues ta anulojë njoftimin për anulim të këtij aktiviteti të prokurimit dhe që të detyrohet autoriteti kontraktues që të vazhdojë më vlerësim të ofertave sipas dispozitave ligjore të ligjit për prokurim publik.

Kërkojmë nga institucioni juaj që të evitohen këto shkelje ligjore, përndryshe do të jemi të detyruar ti ndjekim të gjitha procedurat tjera në organet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Kërkojmë që të na kompenzohen edhe shpenzimet administrative që i kemi bërë në përgatitjen e këtij tenderi.
Njashtu na shkaktohet edhe dëmi për shkak të shkeljeve të këtij autoriteti

Shoqëri me përgjegjësi të kufizuarë GRANITI SHP.K.

kontraktues me rastin e anulimit të këtij aktiviteti të prokurimit pa bazë ligjore.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.

b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".

c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.

d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,

e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,

f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe

g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara GRANITI SH.P.K. SUHAREKË